



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 78/11 prot.

Datë 20.02.2026

V E N D I M

Nr. 290/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.02.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.252/2026, datë 12.02.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “*Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier*” me fond limit 44 449 209. 27 (*dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mije e dyqind e nente pike njezet e shtate*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues:

OE “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N dhe me adresë Lagjja Kastrioti, rruga Andon Profka, 2 kullat Fier.

BOE “NGRACAN 1934” SHPK (përfaqësues) me NIPT J87602809S dhe me adresë, Lagjja "Sheq i Madhe,rruga "Koçi Papuciu", banese private.Nr 53, Fier & “COLOMBO” SHPK

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier me adresë Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 12.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.252/2026, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e OE ankimues “Shëndelli” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE ankimues “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK”, për procedurën e “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE ankimues “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK” dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik ankimues “Shëndelli” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 11563/33 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 78/8 prot., datë 19.02.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Fier, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 252/2026, datë 12.02.2026.

-Urdhërin e autoritetit kontraktor me nr.11563/30 prot., datë 17.02.2026;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 11563/32 prot., datë 17.02.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 11563/33 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 78/8 prot., datë 19.02.2026, autortiteti kontraktor Bashkia Fier, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 252/2026, datë 12.02.2026.

-Urdhërin e autoritetit kontraktor me nr.11563/30 prot., datë 17.02.2026;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 11563/32 prot., datë 17.02.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 11563/33 prot., datë 17.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 78/8 prot., datë 19.02.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.252/2026, datë 12.02.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për BOE “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK dhe statusi i këtij BOE qëndron përsëri “I skualifikuar”.

Ndërsa për operatorin ekonomik “Shëndelli” Shpk, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.252/2026, datë 12.02.2026, duke rivlerësuar këtë subjekt ofertues dhe pas rivlerësimit statusi nga “I skualifikuar” është ndryshuar në statusin “I kualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe procesverbalit të rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 11563/32 prot., datë 17.02.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Gjithashtu, pas rivlerësimit, autoriteti kontraktor nga përlllogaritjet, nuk e ka cilësuar ofertën e OE “Shëndelli shpk” si ofertë anomalisht të ulët, në përputhje me parashikimet e ligjore, dhe në përfundim të analizës, për autoritetin kontraktor është krijuar bindja se është e rregullt me të gjithë elementët e saj, dhe e ka kualifikuar këtë OE, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar si edhe në raportin e auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE).

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “*Rikonstruktion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier*” me fond limit 44 449 209. 27 (*dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mije e dyqind e nente pike njezet e shtate*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

